

Shkresë informative për prindërit e fëmijëve
dhe të rinjve me gjuhë të huaj



Të dashur prindër

Ju e keni lënë vendlindjen tuaj dhe tani jetoni bashkë me fëmijët tuaj në kantonin e Bernës. Ne ju dëshirojmë juve dhe familjes tuaj një fillim të mbarë kurse fëmijës tuaj suksese në shkollë.

Që të mund t'ju informojmë mbi sistemin tonë shkollor, ju ofrojmë këtë shkresë informative. Me këtë përpqemi t'u përgjigjemi pyetjeve për shkollimin e fëmijëve tuaj. Për njoftimet e mëtutjeshme personeli mësimor dhe komisionet e shkollave janë në dispozicionin tuaj.

Drejtoria për Edukim e kantonit të Bernës

Schulen im Kanton Bern
Informationsschrift für Eltern

Albanisch #191687

Download: www.erz.be.ch/elterninfo

Les écoles dans le canton de Berne

Brochure d'information à l'attention des parents

Albanais #191687

Download: www.erz.be.ch/info-parents

Shkollimi...

Fëmijët me gjuhë të huaj gëzojnë të drejtën e shkollimit ngjashëm sikur nxënësit dhe nxënëset e Bernës. Sa më të mëdha të jenë njohuritë në gjuhën gjermane, respektivisht në gjuhën frenge (në pjesët franceze të kantonit) në fund të shkollimit, për aq do të jenë gjasat e suksesit për hyrjen në profesion ose për shkollim të mëtutjeshëm.

Që të mund të gjejnë veten sa më shpejt në rrethin e ri, të porsaardhurit përveç gjuhës duhet të njohin edhe normat e sjelljes të vendit mikpritës dhe me këtë të mësohen të sillen. Edhe këtu vlenë të thuhet: sa më shpejt që të krijohet besimi për aq do të jetë mundësia e qarkullimit të sigurtë në shoqërinë e këtushme.

Modelet e shkollimit janë të ndryshme në secilën shkollë. Të gjitha e kanë të njëjtin qëllim, do me thënë, integrimin.

... në kopshtin e fëmijëve:

Për fëmijët me gjuhë të huaj amtare të mësuarit e gjuhës së folur lokale dhe gjuhës standarde është parakusht për t'u marrë vesh. Përmes një sjelljeje të diferencuar me gjuhën dhe përmes ofertave të posaçme do të përballohet kjo situatë.

Për fëmijët të cilët të kuptohen pak, mund t'u ofrohet një person plotësues i specializuar për ndihmë të posaçme. Qëllimi i kësaj ndihme të posaçme është që fëmijët me mësimin në formë të lojës, të nxiten të mësojnë gjuhën gjermane ose gjuhën frenge (sipas pjesës së kantonit). Mësimi zhvillohet në grupe të vogla.

Kalimi në shkollë mund të lehtësohet me këtë ndihmesë të qëllimshme.

... në shkollën fillore:

Klasët për fëmijët me gjuhë të huaj (kryesisht në qytete)

Pesha kryesore e mësimin qëndron në përvetësimin e gjuhës gjermane, respektivisht të gjuhës frenge në pjesën franceze me qëllim që fëmijës t'i mundësohet të hyjë së shpejti në një klasë të rregullt të shkollës fillore.

Mësimi plotësues (gjermanisht, respektivisht frengjisht për të huaj)

Aty ku nuk mund të realizohen klasët për të huaj, nxënësve me gjuhë të huaj ju ofrohet mësim plotësues, të punohet në drejtim të gjuhës në mënyrë që sa më shpejt të ndjekin mësimin.

... në kohën e pas shkollimit të detyruar

Viti shkollor parapërgatitor për profesione (BVS)

Të rinjtë me gjuhë të huaj jashtë mësimin të detyruar kanë mundësinë të ndjekin një mësim njëvjeçar në një vit parapërgatitor për profesione, nëse ia vlenë në çështjen e integritimit. Qëllimet e integritimit janë të mësuarit e gjuhës gjermane, parapërgatitja për zgjedhjen e profesionit dhe të përshtaturit e nivelit të njohurive të planprogramit mësimor të Bernës (shih *shkollat parapërgatitore për profesione*).

Lirimi nga detyrimi i shkollimit:

Në kantonin e Bernës të rinjtë e ardhur, të cilët sjellin dëshmitë se kanë mbaruar shkollimin e detyruar dhe e kanë kaluar moshën 15 vjeçare, nuk janë më të detyruar për shkollim.

Kurset në gjuhën dhe kulturën amtare

Për të mësuar dy gjuhët (gjermani-shten, gjëgjësisht frengjishten) premisë e rëndësishme është zotërimi i gjuhës amtare.

Ambasadat, konsulatat dhe shoqatat e prindërve ofrojnë kurse për ndihmesë dhe shkollim në gjuhën dhe kulturën amtare. Këto kurse mbahen gjithësejt më së shumti gjysmë dite në javë dhe

mund të ndiqen gjatë orarit të rregullt mësimor në hapësirat e shkollave fillore. Personeli mësimor i fëmijës tuaj do të jetë i gatshëm të ndihmojë për ndjekjen e këtij mësimi.

Kujdesuni që fëmija juaj të mund të ndjekë kursin në gjuhën dhe kulturën amtare. Përvojat e deritanishme tregojnë se me këtë mësim do të forcohet identiteti i ndërtuar dhe sjellur nga vendlindja si dhe ndjenja e vetëvlerësimit të fëmijës. Për një riintegrim eventual të mëvonshëm është një domosdoshmëri lidhmëria me kulturën e trashëguar. Njohuritë në gjuhën amtare lehtësojnë edhe mësimin e dy gjuhëve dhe nxisin rezultatet shkollore (të mësimin).

Sistemi shkollor në kantonin e Bernës

Çështja e shkollës fillore është detyrë e përbashkët e komunave dhe e kantonit. Komunat kujdesen që çdo fëmi të ketë mundësi të ndjekë **shkollën fillore**. Me urdhër të drejtorisë kantonale për edukim të Bernës, **inspektoratet e shkollave** udhëheqin mbikqyrjen profesionale mbi kopshtet e fëmijëve dhe shkollat. Për zhvillimin e veprimtarisë në shkolla në çdo komunë janë përgjegjëse **komisionet shkollore**. Ato zbatojnë mbikqyrjen lokale. Për kopshtet e fëmijëve janë kompetente komisionet e kopshteve të fëmijëve dhe shkollave.

A. Kopshtet e fëmijëve

Në kopshtin e fëmijëve fëmijët fillojnë një rrugë, e cila i shpie për në shkollë.

Kopshti i fëmijëve dhe shkolla kanë qëllime të përbashkëta: ato nxisin vetëpërgjegjësitë, përgjegjësitë e sjelljes shoqërore dhe të lëndëve. Punohet sipas një planprogrami mësimor i cili tregon se cilat aftësi dhe shkathtësi duhet të nxiten në kopshtin e fëmijëve.

Veprimtaria kryesore është loja. Fëmijët mësojnë kur luajnë dhe ata luajnë gjatë mëimit. Klasa e kopshtit të fëmijëve, paisja e saj dhe materialet ofrojnë mundësi dhe aktivizim optimal gjatë lojës së shumëllojshme dhe mëimit.

Secili fëmi ka të drejtë që së paku një vit pa pagesë (falas) të vijojë kopshtin e fëmijëve. Një vit i dytë në kopshtin e fëmijëve mund t'ju ofrohet nga komuna. Edhe pse kopshti i fëmijëve është vullnetarë, atë e vijnë pothuajse të gjithë fëmijët.

B. Shkolla fillore

1. Vështrim i përgjithshëm / Ndarja

Shkolla fillore përfshinë 9 vite të shkollimit të detyruar. 6 vitet e para të shkollës fillore formojnë **Shkollën Primare**, 3 vitet pasuese **Shkollën Sekundare I**. Gjatë shkollimit fillor gjashtëvjeçar të gjithë nxënësit mësojnë bashkarisht. Mësimdhënësit shpesh zhvillojnë mësimin jorigorozisht sipas lëndëve të ndara, por lidhin pjesë nga shumë lëndë rreth temave, Nga viti i 5 shkollor nxënësit mësojnë si gjuhë të huaj të parë gjuhën frenge (respektivisht gjuhën gjermane në pjesën franceze të kantonit). Për ndërrimin nga shkalla primare në shkollën sekundare I zhvillohet **mënyra kaluese**. Me këtë nxënësit e shkollës reale ose sekundare do të caktohen në nivelin e **shkollës reale ose sekundare**. Në pjesën franceze të kantonit nxënësit kalojnë në klasët Reale (klasë/seksione të përgjithshme), klasët Sekundare (klasët/seksione moderne) ose në klasët progjimnaziale (klasët/seksione „preparant aux ecoles de maturite”). Procesi deri te mënyra e kalimit pason me një informacion të mësuesit apo mësueses. Për këtë prindërit marrin një shkresë informative. Në këtë do t'u shpjegohet hollësisht lidhur me kërkesat e kalimit dhe mënyrën e kalimit.

Në pjesën gjermane të kantonit Shkalla Sekundare I (viti shkollor 7-9) ndahet në shkollat reale, shkollat sekundare dhe shkollat me nivele sekundare dhe reale (shkollat me format e bashkëpunimit).

Në pjesën franceze të kantonit klasët e lartëpërmendura gjegjësisht repartet (klasët/seksione) janë vënë në Shkollën Sekundare I parimisht në qendrat e Shkollave Sekundare.

Çdo komunë vendosë vetë, a do të mësojnë nxënësit të ndarë apo pjesërisht bashkarisht. Për shkollat reale dhe sekundare në pjesën gjermane të kantonit vlejné aq sa është e mundur planet dhe mjetet e njëjta mësimore. Në shkollën sekundare do të parashtrihen kërkesa me të larta se sa në shkollën reale.

Në vitin shkollor 7-9, mbahet një parapërgatitje për zgjedhjen e profesionit. Shkolla përkrah këtë proces të rëndësishëm përmes trajtimit përkatës të temave në mësim. Në bashkëpunim me prindërit dhe këshillimores për profesione të rinjtë do të shogërohen në marrjen e vendimit (për zgjedhjen e profesionit). Nxënësit në pjesën gjermane të kantonit të cilët i kalojnë qartë kërkesat bazë të njohurive në lëndët e llojit të shkollës sekundare dhe i plotësojnë kushtet e nevojshme, në fund të gjysmëvjetorit të parë të klasës së 8 mund të paraqiten përmes komisionit shkollor për kalim në mesimin gjimnazial për vitin e 9 shkollor.

(Shih shkollat e maturës (Maturitäts-schulen)

Mbani kontakt me mësuesin ose mësuesen e fëmijës tuaj dhe mos u turpëroni të merrni me vete në bisedim një përkthyes/e të afërt tuajin që e njej gjuhën. Kontakti i juaj i rregullt me shkollën është në të mirë të fëmijës tuaj.

Nëse nuk arrihet një zgjidhje e kënaqshme për shkak të lindjes së pyetjeve dhe vështirësive të çfarëdo lloji, atëherë rastin tuaj parashtroni drejtorisë së shkollës ose komisionit shkollor. Kanë mundësi të ndihmojnë edhe mësimdhënësit e kurseve për gjuhë dhe kulturë amtare.

2. Vlerësimi dhe perspektiva e shkollimit në shkollat fillore

Për informata në fushën e vlerësimit dhe të kalimit nga shkalla primare në shkollën sekundare I në shkollën fillore në kantonin e Bernës ekziston një **shkresë informative për prindërit**. Kjo është e përkthyer në disa gjuhë dhe mund të merret drejtpërdrejt në: schulverlag blmv AG, Güterstrasse 13, 3008 Bern, ose në shkollë ku fëmija juaj mëson. Gjithashtu edhe për kurset e gjuhës dhe kulturës amtare ekziston një **formular vlerësimi**. Ky plotësohet nga një mësimdhënësi i gjuhës dhe kulturës amtare dhe vëhet në dosjen e dokumenteve. Kjo i detyron mësimdhënësit e gjuhës dhe kulturës amtare që këtë raport vlerësimi t'ia dorëzojnë mësimdhënësit të klasës në fund të çdo gjysmëvjetori ose fundviti.

3. Klasët e veçanta (speciale) të shkollës fillore

Disa fëmijë kanë vështirësi të gjenden në një klasë të rregullt. Për ata është mundësuar një shkollim në klasë të veçanta (speciale):

- **Klasa e Vogël A**
për fëmijët me pengesa dhe vështirësi në të mësuar.
- **Klasa e Vogël B**
për fëmijët normal, që kanë nevojë për përkujdesje të posaçme për shkak të vështirësive në sjellje dhe shkollim.
- **Klasa e Vogël C**
për fëmijët normal me të meta trupore.
- **Klasa e Vogël D**
për fëmijët normal me zhvillim të ngadalësuar tek të cilët rezulton se në vend të kthimit të tij prapa, materiali i klasës së 1. ndahet në dy vite.

4. Mësimi special

Nxënësit e klasëve reale me pengesa dhe vështirësi në të mësuar dhe në bazë të kërkesës së këshillimores për edukim, shërbimit psikiatrik për fëmijë dhe të rinj ose të mjekut shkollor mund të caktohen për të ndjekur një *mësim special*.

- **Mësimi shërues pedagogjik**
për nxënësit me pengesa dhe vështirësi komplekse në të mësuar ose për këshillim dhe përkrahje nga prindërit dhe mësimdhënësit me rastin e paraqitjes së situatave të vështira,
- **Mësimi legastenik dhe dyskalkulues**
për nxënësit me vështirësi në të mësuar në lëmitë e gjuhës dhe të matematikës,
- **Mësimi logopedik**
Për nxënësit me zhvillim të ngadalësuar apo të penguar në të folur dhe në gjuhë.
- **Mësimi psihomotorik**
Për nxënësit me vështirësi në lëmin e të perceptuarit fizik të trupit dhe lëvizjeve.

5. Përmbledhje e shkurtër e përcaktimeve ligjore

- Të përgjithshme**
 - Shkolla publike fillore është neutrale ndaj fesë. Ajo nuk guxon të cënojë lirinë e mendimit dhe besimit si dhe të drejtat e edukimit të prindërve të rregulluara në bazë të ligjit civil.
 - Mësimi në shkollat fillore është pa pagesë.
 - Komuna u jep nxënësve pa pagesë mjetet e mësimin dhe materialet shkollore.
- Vijimi i shkollës**
 - Prindërit janë të detyruar t'i dërgojnë rregullisht fëmijët e tyre në shkollë.
 - Për prindërit është e dënueshme mosdërgimi në shkollë i fëmijës. Komisioni i shkollës në këso rastesh pas dëgjimit të prindërve do të paraqesë padi.
- Mungesat dhe liri**
 - Prindërit kanë të drejtë që pas paralajmërimit, më së shumti pesë gjysmë dite në vit, të mos i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë.
 - Mungesat e paparashikuara dhe mungesat e shkurtëra vlejnë si të arsyeshme në mes të tjerave për arsyet e poshtëshënuara:
Sëmurja ose fatkeqësia e fëmijës, sëmurje ose rast vdekjeje në familje, pushimi rehabilitues mjekësor i njërit prind, ndërrimi i banesës, takimet me mjekun dhe vizita te mjeku i dhëmbëve.
Prindërit njoftojnë mësimdhënësin për arsyet e mungesave.
Komisioni i shkollës mund të kërkojë arsyetime me shkrim dhe në raste të veçanta vërtetim të mjekut.
 - Kërkesa për leje mund të drejtohet në mes tjerash për arsyet e poshtëshënuara: festa të mëdha fetare, ngjarje të rëndësishme familjare, ndjekja e kursit në gjuhën dhe kulturën amtare (deri gjysmë dite në javë), absolvimi (përfundimi) i mësimin praktik.

Qëndroni në kontakt me kohë me mësimdhënësit dhe drejtorinë e shkollës. Ata u japin njoftime për kompetencat dhe veprimet për mungesat dhe lejet.

- Disiplina, masat**
 - Nxënësit dhe nxënëset duhet të zbatojnë urdhërat e mësimdhënësve dhe organeve shkollore.
 - Mësimdhënësit janë të plotëfuqishëm të marrin masa ndaj nxënësve që bëjnë gabime. Në raste veçanërisht të rënda, komisioni shkollor mund të largojë nga shkolla nxënësit maksimalisht deri në 12 javë.
 - Dinjiteti i nxënësve dhe të drejtat e prindërve janë të mbrojtura.
- Shërbimet shëndetësore dhe të këshillimit**
 - Shërbimi mjekësor i shkollës është çështje e komunave. Ato mbikqyrin gjendjen shëndetësore në shkollat private dhe publike të shkollës fillore dhe marrin masat e nevojshme. Gjendja shëndetësore e nxënësve do të përcillet përmes kontrollimeve periodike nga ana e mjekut shkollor.
 - Komunitat udhëheqin shërbimin dentar shkollor në shkollat e rrethit të tyre.
 - Për sqarim në këshillimorën për arsim dhe shkollim të mëtutjeshëm në komunitat e mëdha janë në dispozicion qendra rajonale për këshillime për arsimim.

Adresat:

Drejtoria për Edukim e Kantonit të Bernës; Enti për Kopshtin e Fëmijëve, Shkolla fillore dhe e mesme: Sulgeneckstrasse 70, 3005 Berne, Tel: 031 / 633 84 55

Informatat për **kurset në gjuhën dhe kulturën amtare** Ua jep shkolla, ambasada; respektivisht për shqiptarët Lidhja e Arsimitarëve dhe Prindërve Shqiptarë (LAPSH) apo drejtoria për edukim (Amt für Bildungsforschung: Tel. 031 633 85 07).

Komisioni i kopshtit të fëmijëve: Emri dhe adresa e kryetarit mund të merren në kopshtin e fëmijëve ose në administratën komunale.

Komisioni shkollor: Emri dhe adresa e kryetarit mund të merren në shkollë ose në administratën komunale.

Mjeku shkollor: Emri dhe adresa e kryetarit mund të merren në shkollë ose në administratën komunale.

Mjeku shkollor i dhëmbëve: Emri dhe adresa e kryetarit mund të merren në shkollë ose në administratën komunale.

Këshillimorja për edukim: Adresa dhe telefoni mund të merren në shkollë ose në drejtorinë për edukim.

Këshillimorja për profesione: Adresa dhe telefoni mund të merren në shkollë ose në qendrën kryesore të këshillimores për profesione dhe shkollim të mëtutjeshëm (Zentralstelle für Berufs- und Laufbahnberatung) Brunngasse 16, 3011 Bern; Tel.: 031/ 633 49 01

Pas mbarimit të shkollës janë të mundshme format e poshtëshënuara të shkollimit (Shkalla sekundare II):

C. Shkollat parapërgatitore për profesione (Berufsvorbereitungsschulen BVS)

Viti shkollor parapërgatitor për profesione iu ofron mundësinë nxënësve që pas përfundimit të shkollës fillore të fitojnë njohuri profesionale ose personale që të mund të fillojnë një shkollim të mëtutjeshëm ose në një shkollim të4 përshtatshëm profesional. Në qendër qëndrojnë kërkesat e pjekurisë së zgjedhjes së profesionit dhe përpunimi i deficiteve personale shkollore.

Ofertat bazë janë:

- **BSI:** parapërgatitja për profesion me çështje kryesore integrimin e nxënësve të huaj,
- **BSP:** parapërgatitja për profesion me çështje kryesore në mësimin praktik,
- **BSA:** parapërgatitja për propfesion me çështje kryesore në shkollimin e përgjithshëm.

Për ndjekjen e një viti shkollor parapërgatitor për profesione pas përfundimit të shkollës fillore nxënësit duhet të kenë parasysh:

- për zgjedhjen e profesionit ose për parapërgatitje të shkollimit profesional kanë nevojë për një vit shkollor plotësues,
- të marrin parasysh të dëshmuarit e deficiteve shkollore reale për qëllime të profesionit,
- të jenë të motivuar që të bëjnë një vit shkollor plotësues,
- të jenë të gatshëm që në ofertën bazë përkatëse të tregojnë përkushtimin që kërkohet, dhe
- që procedura e pranimit të jetë përfunduar me sukses.

Njoftime për paraqitje, leje dhe mbi kushtet e mëtutjeshme për ndjekjen e një shkolle të një viti parapërgatitor të profesionit (BVS) mund t'i merrni te mësimdhënësit e klasës 9, në drejtori të shkollës, te shkollat për profesione ose te: Erziehungsdirektion des Kantons Bern, Mittelschul- und Berufsbildungsamt, Sulgeneckstrasse 19, 3007 Bern; Tel.: 031/633 87 00

Informacione të posaçme për shkollat e një viti parapërgatitor të profesioneve (BVS) me çështje kryesore integrimin ju japin:

- Berufs- Fach- und Fortbildungsschule, Monbijoustr. 21, 3001 Bern; Tel. 031 384 33 00, e-mail: bffbern@bern.ch
- Berufsbildungszentrum Biel, Wasenstr. 5, Postfach 4264, 2500 Biel; Tel. 032 344 37 52, e-mail: info@bbz-biel.ch
- Centre de formation professionnelle Bienne, Rue du Wasen 5, Case postale 4264, 2500 Bienne; Tel. 032 344 37 52, e-mail: info@bbz-biel.ch
- Gewerblich-industrielle Berufsschule, Zähringerstr. 13, 3400 Burgdorf; Tel. 034 427 22 22, e-mail: info@gibbul.ch

- Berufsschulzentrum Oberland, Obere Bönigstrasse 21, Postfach, 3800 Interlaken; Tel. 033 828 11 11, e-mail: mailbox@bzi-interlaken.ch
- Gewerblich-industrielle Berufsschule, Weststr. 24, 4900 Langenthal; Tel. 062 916 86 66, e-mail: info@gibla.ch
- Centre professionnel artisanal et industriel du Jura bernois, Rue de la Clef 44, case postale 51, 2610 St. Imier; Tel. 032 942 42 48, e-mail: cpai.jb@swissonline.ch
- Schlossbergschule, Schulanlage Räumli, Schlüsselmatteweg 23, 3700 Spiez; Tel. 033 225 12 88,
- e-mail: info@schlossbergschule.ch

D. Paramësimi (Vorlehre)

Në **paramësim** të rinjtë do të nxiten në punishtet paramësimore dhe në shkollën profesionale që pas ndjekjes së paramësimit të **mësimit të një profesioni** ose **të përvetësimit praktik**, të cilat iu përgjigjen aftësive dhe parashikimeve të tyre. Paramësimi iu dedikohet:

- nxënësve që nuk kanë gjetur vend mësimi të profesionit dhe atyre që janë të papunë, të cilët mund të parapërgatiten për shkollim të një profesioni në kuadër të një viti të ndërmjetëm,
- për të rinjtë e huaj dhe zviceranë, të cilët për shkak të mangësive të parakushteve shkollore dhe vështirësive të tyre gjuhësore nuk mund të fillojnë në një mësim të profesionit,
- për të rinjtë e huaj të cilët qe një kohë të shkurtër (2 - 4 vjet) jetojnë në territorin gjermanofolës dhe për shkak të mungesës së njohurive të gjuhës gjermane ende nuk mund të fillojnë një mësim të profesionit.

Informacione për paraqitje, pranim dhe kushte të tjera për ndjekjen e një **paramësimi** japin:

- Gewerblich-Industrielle Berufsschule Bern; Lorrainestr. 1; Tel. 031 335 91 46
- Gewerblich-Industrielle Berufsschule Burgdorf, Zähringerstr. 13; Tel. 034 427 22 22
- Gewerblich-Industrielle Berufsschule Biel, Wasenstr. 5; Tel. 032 344 37 52
- Centre de formation professionnelle Bienne, Rue du Wasen 5, Tel. 032 344 37 52
- Schlossbergschule, Schulanlage Räumli, Schlüsselmatteweg 23; Tel. 033 225 12 88
- Berufs- Fach- und Fortbildungsschule, Monbijoustr. 21, 3001 Bern; Tel. 031 384 33 00

E. Mësimi i profesionit (Berufslehre)

Pas mbarimit të shkollimit të detyruar një pjesë e madhe e të rinjve i hyjnë mësimit të një profesioni. Mësimi i një profesioni ndërmjetëson arsimimin teorik dhe praktik në një profesion. Pranë veprimtarisë praktike në një ndërmarrje një nxënës/e ndjek 1-2 ditë në javë një shkollë për

profesione. Një mësim zgjatë në kushte normale sipas drejtit të profesionit 2-4 vite dhe përfundon me një provim përfundimtar (të pjekurisë), i cili përfundon me një dëftesë pjekurie.

Shumica e shkollave të profesioneve zejtare-industriale në kantonin e Bernës ofrojnë kurse plotësuese ndihmëse (për ata me mangësi në mësim, vështirësi në të mësuar, vështirësi në të kuptuar për shkak të gjuhës së huaj).

Shkolla e maturës së profesioneve (BMS) ndërmjetëson për nxënësit e talentuar dhe atyre me vullnet për rezultate si plotësim i mësimi të detyruar një arsimim teorik të zgjeruar për thellimin dhe zgjerimin e arsimit të përgjithshëm. Ajo u mundëson pas mbarimit të mësimi dhe i liron nga provimi pranues për në Shkollën e Lartë Profesionale.

Njoftime të tjera japin:

- die Erziehungsdirektion des Kantons Bern, Mittelschul- und Berufsbildungsamt, Sulgeneckstr. 19, 3007 Bern; Tel. 031 633 87 00
- die regionalen Berufs- und Laufbahnberatungsstellen oder die Zentralstelle für Berufs-, Studien- und Laufbahnberatung, Brunngasse 16, 3011 Bern, Tel. 031 633 49 01

F. Mësimi praktik i profesionit (Anlehre)

Mësimi praktik i profesionit iu ndërmjetëson të rinjve me prirje praktike zotërimin proceseve të thjeshta të punës dhe të fabrikave. Mësimi praktik i profesionit zgjatë më së paku një vit, sipas rregullit dy vite. Nxënësit e mësimi praktik të profesioni ndjekin një ditë në javë shkollën e profesioneve në klasë të veçanta. Parashihet që nga viti 2005 mësimi praktik i profesionit do të zëvendësohet me një shkollim themelor dyvjeçar, i cili mbaron me një provim dhe dëshmohet me një çertifikatë federale. Momentalisht në kantonin e Bernës funksionojnë pilotpërprojekje përkatëse.

Informacione për paraqitje, pranim dhe kushte të tjera për ndjekjen e një **mësimi praktik të profesionit** japin:

- Erziehungsdirektion des Kantons Bern, Mittelschul- und Berufsbildungsamt, Sulgeneckstr. 19, 3007 Bern; Tel. 031 633 87 00
- Berufsbildungszentrum Biel, Wasenstr. 5; Tel. 032 344 37 52
- Centre de formation professionnelle Bienne, Rue du Wasen 5, Tel. 032 344 37 52
- Gewerblich-industrielle Berufsschule Bern, Lorrainestr. 1; Tel. 031 335 91 46
- Gewerblich-industrielle Berufsschule Thun, Mönchstr. 30B; Tel. 033 227 33 44
- Berufs-, Fach- und Fortbildungsschule Bern, Monbijourstr. 21; Tel. 031 384 33 00

G. Shkollat e mesme me diplomë (Diplommittelschulen)

Ato parapërgatisin nxënësit në një shkollim dyvjeçar për plotësimin dhe zbatimin e mëtutjeshëm të dijeve shkollore sekundare për fillimin e një profesioni nga moshë 18 vjeçare. Këtu ka të bëjë me profesione në shëndetësi, në profesione sociale.

Formimi i personalitetit dhe ndërmjetësimi i teknikës së punës janë çështje të rëndësishme të këtyre shkollave.

Qyteti Moutier në pjesën franceze të kantonit zbaton një shkollë të Mesme me Diplomë me mësim trevjeçar.

Njoftime të mëtutjeshme japin shkollat e lartëpërmendura ose qendrat rajonale për këshillime të profesioneve dhe të perspektivës së shkollimit të mëtutjeshëm (die regionalen Berufs- und Laufbahnberatungsstellen).

H. Shkollat e maturës / gjimnazet (Maturitätsschulen/Gymnasien)

Mësimi gjimnazial në pjesën gjermane të kantonit fillon me vitin e 9. shkollor në shkollën sekundare ose në një **gjimnaz** dhe zgjatë gjithësejt katër vite. Nga viti i dhjetë shkollor të gjithë nxënësit ndjekin një gjimnaz dhe zgjedhin **një drejtim (lëndë) kryesor**. Në pjesën franceze të kantonit hyrja në gjimnaz pason pas kohës së detyruar për shkollim nëpër **klasët progjimnaziale**, nën kushtet e njohura për klasët sekundare; kohëzgjatja e shkollimit është tri vite (viti i 10.-12. shkollor).

Shkollimi në një gjimnaz përfundon me një **provim të maturës** (provim diplome). Para provimit në të vërtetë dorëzohet **tema e maturës** (diplomës). Dëftesa e maturës (diploma) jep të drejtën e studimeve në universitete, në arsimim për mësimdhënës ose të studimeve në shkolla të larta shtetërore (ETH).

Informatat si dhe njoftimet më të përafërta i merrni në drejtorinë e gjimnazit të rajonit tuaj.